

VENDIM
Nr. 425, datë 23.7.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 110, DATË 19.2.2025, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË
KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË
TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2025”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun I, të lidhjes 1, të vendimit nr. 110, datë 19.2.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimi në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2025”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Koordinator në sektorin (zyrën) e menaxhimit pranë Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm, në Kryeministri, gjithsej, 4 pozicione.”.

b) Pikat 10, 16 dhe 23 shfuqizohen.

2. Ngarkohen Kryeministria dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku